



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Nr 148 Prot

Shkodër me 3003 2023

V E N D I M

Nr. 05, Datë 30.03.2023

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT TË VITIT 2022 TË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2023, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 40, 41, 44, 77 shkronja dh, 78, pika 3 të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 48 të Ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr.22, datë 30.7.2018 "Per procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njëjësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Ligjin 155/2021 "Per Buxhetin e Vitit 2022", VKQ Shkoder nr.17, datë 30.12.2021 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022 dhe PBA Përfundimtare 2022-2024", diskutimit në komisionet përkatëse dhe pasi u diskutua në mbledhjen e kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër dt.21.03.2023, bazuar edhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13 dhe 15 i saj,

Pas relatimit nga Zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit, u kalua në procesin e votimit ku u miratua me **13 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim.**

V E N D O S I ;

1. Miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2022 dhe tabelat e realizimit të buxhetit, pjesë përbërëse të këtij vendimi, për ;
 - a) Raportin e shpenzimeve sipas programeve
 - b) Raportin e shpenzimeve të programeve sipas artikujve

- c) Projektet e investimeve me financim të brëndshëm.
- d) Treguesite ekonomike financiare.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI
Hilmi LAKTI





REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Shkodër me 23/02/2023

Raport mbi zbatimin e monitorimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për periudhën 12/mujore Janar – Dhjetor 2022

1- Hyrje

Realizimi i buxhetit për Këshillin e Qarkut Shkodër Buxhetit per periudhen 12/mujore, Janar – Dhjetor 2022, është bërë duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015”Për Vetëqeverisje Vendore”, nenin 48 të Ligjit Nr.68/2017 ”Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008” Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise”,i ndryshuar, si dhe Udhezimin nr 22, datë 30.07.2018 ”Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit te Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, si dhe Vendimin e Këshillit të Qarkut Shkodër nr.17,datë 30/12/2021 “Mbi miratimin e buxhetit të KQSH për vitin 2022” dhe shprehje ligjore nr. 19/1, date 11.01.2022.

Qarku , si njësi e nivelit të dytë të Vëtëqeverisjes Vendore, ushtron funksionet e veta për ndërtimin e zbatimin e politikave rajonale duke berë harmonizimin e e tyre me politikat shtetërore në nivel qarku, kryen dhe ushtron kompetencat e deleguara nga pushteti qendror për Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) si dhe kryen funksione te tjera qe i delegohen nga bashkitë e qarkut në zbatim të marreveshjeve të lidhura mes palëve. Programi Buxhetor Afatmesem, parashikon mbulimin sa me efçencë të funksioneve te tij, për të zbatuar politikat dhe misionin e ngarkuar.

Këshilli i Qarkut Shkodër, menaxhon fondet duke u bazuar ne programet e mëposhtme ;

- ✓ **P-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut (Planifikim, menaxhim, administrim).**
- ✓ **P-01160-Programi i administratës Vendore të qarkut, funksion i deleguar (Planifikim, menaxhim, administrim),(DAMT).**
- ✓ **P- 04520-Programi i Rrjetit Rrugor Rural.**
- ✓ **P-04760- Programi per Mbeshtetje dhe implementim i projekteve ne kuadër te politikave rajonale per zhvillim ne fushen e turizmit**
- ✓ **P-06370-Programi i furnizimit me ujë.**
- ✓ **P-10460-Programi ne fushën e Shërbimeve te Përkujdesjes në qarqe**

2- Përshkrim i Përgjithshëm mbi procesin e monitorimit dhe realizimi i buxhetit.

Sipas nenit 38 te ligjit 139/2015”Për vetëqeverisjen vendore”, pika 1 dhe 2, qarku krijon të

ardhura nga burimet e veta vendore dhe te ardhura qe rrjedhin nga burime kombetare.
Të ardhurat nga përgjithshme vendore të Këshillit të qarkut Shkodër për vitin 2022 janë 138,785 mijë lekë dhe përkatësisht;

- Transfera e pakushtezuar per kryerjen e funksioneve te KQSh është 57,734 mijë lekë.
- Transfera e keshtezuar per kryerjen e funksioneve te deleguara është 11,740 mijë lekë.
- Të Ardhura nga tarifa per shërbime Publike e planifikuar 150 mijë lekë dhe kuota e antarësisë e përcaktuar me VKB të pesë njësisive vendore të qarkut Shkodër, është 1,940 mijë lekë, në shumë totale 2,090 mijë lekë.
- Të ardhura të trashëguara nga viti 2021 ne shumë 64,380 mijë lekë
- Fonde me financim te huaj(Kap.2 dhe 6) 2,841 mijë lekë.

Për vitin 2022, të Ardhurat e planifikuara të Këshillit të Qarkut Shkodër, kanë qenë 2,090 mijë lekë, nga të cilat të ardhurat nga shërbimet do jenë 150 mijë lekë dhe nga Kuota e Antarësisë për Bashkitë e qarkut Shkodër ka qenë në masën 1,940 mijë lekë, sipas Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër nr. 2, datë 06.04.2022 dhe shprehje ligjore nr. 256/1, datë 22.04.2022.Kemi lidhur marrëveshjet me Bashkitë e qarkut Shkodër për arkëtimin e kësaj kuaote.

a- Realizimi i të Ardhurave.

Te ardhurat e realizuara deri me **30.12.2022** në lekë, paraqiten si me poshtë;

- Te ardhura nga kuota e antaresise	1,940 leke
- Të ardhura nga sherbime kadastrale	45 mijë lekë
- Të ardhura nga konfirmim	28 mijë lekë
- Te ardhura nga nxjerrje doc.arshivore	7.2 mijë leke
- Te ardhura Gjithsej	2020.2 mijë leke

Kuota e antarësisë e miratuar në mbledhjen e Keshillit të Qarkut Shkodër me datën 06.04.2022, nga Bashkitë e qarkut Shkodër është;

➤ Bashkia Malësi e Madhe	shuma	200,000 lekë
➤ Bashkia Vau Dejës	shuma	600,000 lekë
➤ Bashkia Shkodër	shuma	1,000,000 lekë
➤ Bashkia Fushë Arrëz	shuma	100,000 leke
➤ Bashkia Pukë	shuma	40,000 leke
	Totali	1,940,000 leke

Plani total i të ardhura nga shërbimet për 12/mujorin është planifikuar në shumë 150 mijë lekë dhe realizimi është në masën 53.47 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave nga kuota e antarësisë ka qenë i planifikuar në masën 1940 mijë lekë dhe është realizuar 100% .

Plani analitik i të Ardhurave dhe realizimi per 12/mujorin e vitit 2022, paraqitet sipas

tabeles së mëposhtme;

Në 000/lekë

Nr	EMERTIMI	Plani	Fakti	Realizimi
		12/mujor	12/mujor	Ne %
1	Te ardhura nga kuota Qarkut per 2022	1,940	1,940	100%
2	Te ardhura nga sherbime të DAMT	50	45	90%
3	Te Ardh.konf.hartash	50	28	56 %
4	Tarifanxj.Doc.arshivore	50	7.2	14.4%
Totali		2,090	2020.2	96.7%


Siç shihet nga tabela e mesiperme:

Te Ardhurat e planifikuara për periudhën 12/mujore kane qene 2,090 mijë lekë dhe janë realizuar në masën 2,020.2 mijë lekë ose 96.7 % e tyre.

Tek realizimi i të ardhurave totale në masën 96.7%, ndikim ka patur realizimi 100% i kutës së qarkut të vitit 2022.

Te ardhurat që janë planifikuar për kryerje shërbimesh, si efekt i kompetencave ligjore qe kane qarqet, jane pothuaj të pakonsiderushme.

Të ardhurat e planifikuara nga shërbimet zënë 7.18% në totalin e të ardhurave te planifikuara për vitin 2022. (shih grafiken)



b-Realizimi i shpenzimeve buxhetore

Gjatë 12/mujorit të vitit 2022 ne Keshillin e Qarkut janë realizuar shpenzimet sipas programeve të planifikuar buxhetore sic jane ;

- ✓ **Prog.-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut** (Planifikim, menaxhim, administrim).

- ✓ Prog-01160- Programi i administratës Vendore të qarkut ,funksion i deleguar(DAMT).
- ✓ Prog- 04520- Programi i Rrjetit Rrugor.
- ✓ Prog-04760- Programi per Mbeshtetje dhe implementim i projekteve ne kuadër te politikave rajonale per zhvillim ne fushen e turizmit
- ✓ Prog-06370- Programi i furnizimit me ujë.
- ✓ Prog-10460- Programi ne fushën e Shërbimeve te Përkujdesjes në qarqe.

Siç shihet nga aneksi nr. 1”Raporti i shpenzimeve sipas programeve”, realizimi i buxhetit për peridhën e parë/2 /mujore është në masen 37 %. Arsyet për këtë masë të realizimit të shpenzimeve i shtjellojmë më poshtë sipas programeve;

Realizimi sipas Programeve;

- ✓ **Prog.-01110-Programi i administratës Vendore të qarkut (Planifikim, menaxhim, administrim)**

Ky program përfshin planifikimin, menaxhimin dhe administrimin e institucionit tone, per te mundesuar përgatitjen, zhvillimin dhe zbatimin e politikave të kuadrit ligjor ne fuqi.

Siç shihet nga aneksi 2, Buxheti vjetor 2022 për këtë Program është në total 40,265 mijë lekë dhe përfshin shumën 39,655 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e vitit dhe 610 mijë lekë fonde me financim të huaj, ose 29 % e buxhetit total të Këshillit të Qarkut Shkoder. Për periudhën 12/mujore buxheti i planifikuar i këtij programi ka qenë në masën 40,265 mijë lekë ndërsa fakti i shpenzimeve është 24,960 mijë lekë ose realizimi në masën 62% ndaj planit të këtij programi. Analizojmë shpenzimet sipas artikujve;

Ky program përfshin;

- Shpenzimet e personelit nga tranferta e pakushtezuar e vitit 2022. Kemi synuar sigurimin e mbeshtetjes së funksionimit të administrates se KQShkodër përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga dhe sigurime shoqërore të cilat për 12/mujorin shpenzimet për paga, janë realizuar ne masen 92%, ndersa për sigurime shoqërore janë realizuar ne masen 92 %.Zbatimi i buxhetit për shpenzime përsonele u bazua te numri i punonjësve i cili per keshillat e qarqeve eshte i përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit me 10 punonjës administrativ dhe 3 të zgjedhur si dhe ne nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet ligjore në fuqi, brënda kufirit minimal dhe maximal te miraruar.Pagat bëhen në zbatim të VKM-së nr. 165,date 02.03.2016, i ndryshuar.
- Shpenzimet operative janë planifikuar për 12/mujorin në masen 11,250 mijë lekë dhe jane realizuar 7,452 mijë lekë.Këtu përfshihet edhe shuma prej 1,000 mijë lekë e planifikuar nga të ardhurat me destinacion per muzeumin Etnografik, shpenzim ky i parealizuar për shumë arsye kordinimi me institucionet e tjera pjesëmarrëse që do përfshiheshin në këtë aktivitet. Realizimi i aktiviteteve të këtij programi për shpenzimet operative për funksionimin e administratës së qarkut Shkodër , duke mos përfshirë

aktivitetin per muzeumin Etnografik është realizuar në masën 72.71% .Në këtë mosrealizim, kanë ndikuar kryesisht dy aktivitetet e planifikuara në buxhet , perkatsisht aktiviteti nr.18 “Monitorimi i strategjisë së turizmit në qarkun Shkodër” në vlerën 160 mijë lekë dhe aktiviteti nr.19 ”Panairi ndërkuftar për ekspozimin e produkteve bujqësore përreth zonës së liqenit të Shkodrës” në vlerën 350 mijë lekë.

Mbetejet nga prokurimet e blerjes dhe kryerjeve të shërbimeve administrative përbëjnë pjesën tjetër të mosrealizimit në këtë zë buxheti.


- Transferta korrente te brendshme , ze i cili përfshin transfera që Keshilli i Qarkut Shkodër bën në zbatim të VKM-ve dhe Vendimeve të Keshillit. Per 12 mujorin e këtij viti janë planifikuar 850 mijë lekë ndërsa realizimi është 100%. Ne këtë zë buxheti, shuma prej 550 mijë lekësh e planifikuar per Emergjencia Civile nuk është realizuar.(Kjo shumë është planifikuar në zbatim të shkresës së MFE-së)
- Transferta korrente të jashtme perfshijnë kuotacionet qe qarku paguan ndaj organizatave partnere ku aderon si CPMR dhe EUSAIR .Per 12 mujorin ka qenë planifikuar vlera prej 352 mijë lekësh dhe realizimi ka qenë 305 mijë lekë mje një diferencë prej 47 mije lekësh e cila ka rrjedhe nga ndryshimi i kursit te këmbimit nga momenti i planifikimit të fondeve ne momentin e kryerjes së pagesës.Pra realizimi i këtij zeri buxheti është 100%.
- Transferta tek buxh familjare perfshin shumat qe i paguhen punonjesve per persona ne ngarkim sipas VKM, i cili është planifikuar për 12/mujorin në masën 34 mijë lekë dhe realizuar në masën 15 mijë lekë.Realizimi është bërë konform akteve ligjore në fuqi.
- Ne shpenzime kapitale te këtij programi janë planifikuar shpenzime per paisje zyrash te cilat jane planifikuar për 12/mujor në masën 300 mijë lekë dhe jane realizuar në masën 242 mijë lekë ose 80.67%.

Në këtë program, në shpenzimet kapitale, është planifikuar shuma prej 7,319 mijë lekësh për investimin”Rrethim e sistemim i varrezave të qytetit Pukë”.

Ky investim nuk është realizuar për arsye objektive të Bashkisë Pukë.

Realizimi i shpenzimeve korrente, bazuar në faktin e shpenzimeve të kryera , është 77%, ndërsa realizimi i shpenzimeve kapitale është 3.185.

Realizimi në total i ketij programi per vitin 2022, eshte ne masen 62%. , ku pjesën më të madhe të mosrealizimit të këtij programi e zë mosrealizimi i investimit të planifikuar në Bashkinë e Pukës.



Prog.-01160- Programi i administratës Vendore të qarkut, funksion i deleguar (DAMT).

Këshilli i Qarkut shkodër, në varësi të tij ka edhe DAMT-në , i cili ushtron aktivitetin e vet me fonde të kushtëzuara nga Ministria e Brëndshme .


Zbatimi i Buxhetit për vitin 2022, është i pasqyruar ne Aneksin 2.program 01160.

Ky program zë 4% të totalit të përgjithshëm të Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022 dhe perfshin;

- Koston e personelit nga tranferta e kushtezuar e vitit 2022 e cila për 12/mujorin per paga është realizuar ne masen 96.33% dhe për sigurime shoqërore është realizuar në masën 100%. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve i cili per DAMT, është i përcaktuar me 6 punonjës administrativ dhe në nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Pagat bëhen në zbatim të VKM-së nr. 187,date 08.03.2017, i ndryshuar.
- Shpenzimet operative të cilat për 12/mujorin 2022, kanë qenë planifikuar në masën 300 mijë lekë dhe realizimi është në masën 256 mijë lekë ose 85.3%.
- Për vitin 2022, është berë shtesë fondi në Art.606”Transferta ne Buxhete familjare” shuma prej 80 mijë lekësh e cila është realizuar 100%.

Realizimi i shpenzimeve total i ketij programi per 12 mujorin e vitit 2022, është ne masen 96.26% .

Të ardhurat e planifikuara per sherbime të kryera nga DAMT, për periudhën 12/mujore kane qenë 50 mijë lekë ndërsa fakti i të ardhurave të kësaj periudhe është 45 mijë lekë ose janë realizuar 90% e tyre.Ky realizim në këtë %, është rezultat i planifikimit të ulët, mbështetur në faktin e vitit të mëparshëm dhe kërkesave në rënje të komunitetit për këto shërbime kadastrale të ofruara nga kjo drejtori.




✓ **Prog-04520-Programi i rrjetit Rrugor Rural.**

Në programin – Rrjeti rrugor, është përfshirë shuma e planifikuara në vlerën 23,362 mijë lekë për vitin 2022, për rikonstruksione rrugësh, shumë e cila zë 17% të totalit të përgjithshëm të Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022. Nga shuma 23,362 mijë lekë 2,467 mijë lekë janë diferenca fondesh me destinacion por që kanë mbetur tek ky program. Shuma e planifikuar për investime është 20,895 mijë lekë dhe përfshin;

- Investimin “**Sistemim, Asfaltim i rrugëve të brendshme në Fshatin Nënshat**”, **Bashkia Vau Dejës**, si prioritet i kësaj bashkie, me vlerë projekti që është financuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër në shumën **14,750 mijë lekë**. Për këtë investim është lidhur kontrata me nr. 337, datë 09.08.2022 dhe kanë përfunduar punimet brenda afatit kohor. Planifikimi i këtij investimi ka qenë 14,750 mijë lekë ndërsa vlera e situacionit përfundimtar ka qenë në shumën 10,320 mijë lekë, me një kursim fondi si rezultat i procedurave të prokurimit rreth 30%.

Si rezultat i procedurës elektronike me objekt “Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme në fshatin Nënshat”, Bashkia Vau Dejes është kursyer 23% e fondit limit, përkatësisht vlera prej 3,690,789 (tre milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.



- Investimi “**Sistemim, asfaltim rruga kryesore e varrezave në fshatin Kalldrun**” **Bashkia Malësi e Madhe** ka përfundur me datë 28.08.2022. Vlera totale e investimit sipas situacionit përfundimtar është 4,789,860 lekë nga 6000 lekë që ishte planifikuar. Kemi një kursim rreth 20% të fondeve publike si rezultat i kryerjes së procedurave elektronike. Mbikqytja dhe kolaudimi i këtij investimi edhe pse ka qenë planifikuar të kryhet me fondet e KQShkodër, është realizuar nga fondet e Bashkisë Malësi e Madhe.

Si rezultat i procedurës elektronike me objekt “Sistemim asfaltim rruga kryesore e varrezave në fshatin Kalldrun”, Malësi e Madhe është kursyer 17% e fondit limit, përkatësisht vlera prej 1,006,600 (një milion e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë.



- Diferenca e mbetur në shumën prej 2,467 mijë lekë, përshin shumën 2,193 mijë lekë diferenca prokurimi me destinacion si dhe shuma prej 274 mijë lekësh obligime për investime.

✓ **P9-Programi për Mbeshtetje dhe implementim i projekteve në kuadër të politikave rajonale për zhvillim në fushën e turizmit**

Këshilli i Qarkut Shkodër, për vitin 2022 ka planifikuar fonde për bashkëfinancime me projekte me financim të huaj në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Financave për Projektet me Financim të Huaj nr.35, datë 21.09.2020.

Meqenese ne kemi aplikuar në disa projekte kryesisht në fushën e turizmit, kemi bërë planifikimin në këtë program në shumën 661 mijë lekë nga Transferta e Pakushtëzuar e trashëguar dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2021.

Edhe pse ne kemi aplikuar në disa projekte, gjatë 12/mujorit të këtij viti, nuk kemi patur asnjë përgjigje nga programet në të cilat ne kemi aplikuar dhe prandaj edhe fakti i shpenzimeve në këtë program është 0.

Në këtë program përfshiht edhe shuma e fondeve me financim të huaj në vlerën 2,231 mijë lekë, të mbetura nga projekti ADRITICAVES, i cili është mbyllur në mars të vitit 2021, por këto fonde kanë mbetur si pasoje e vazhdimit të procedurave me rimbursimet e shpenzimeve nga projekti.

Shuma totale e këtij programi për vitin 2022 është 2,892 mijë lekë, dhe zë 2% të fondeve totale të Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër.

✓ **Prog-06370-Programi i furnizimit me ujë.**

Në buxhetin e vitit 2022, kemi planifikuar shumën prej 60,526 mijë lekësh për investimin "Ndertimi i Ujësjellësit Muriqan, Bashkia Shkodër", nga të cilat 58,263 mijë vlerë ndertimi, 1,968 mijë për mbikqyrje punimesh dhe 295 mijë lekë për kolaudim punimesh.

Vlera e projektit të këtij investimi është 98,181 mijë lekë.

Në këtë program janë përdorur fondet për Oponence teknike të projektit në shumën 75 mijë lekë si dhe 200 mijë lekë për Taksa e Tarifa Ndertimi.

Spektori i Prokurimeve Publike në vitin 2022, është përballur me anulimin e një investimi shumë të rëndësishëm për komunitetin e Bashkisë Shkodër, me objekt "Ndërtim Ujësjellësi

në Fshatin Muriqan”, me fond limit 82,627,173 (tetëdhjetë e dy milion e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa t.v.sh. bashkëfinancim i Këshillit të Qarkut Shkodër me Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM). Arsyeja e anulimit është skualifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrëse në dhjetor 2022. Kjo solli dhe moskryerjen në kohë të kësaj procedurë dhe të këtij investimi.

Anullimi i procedurës së tenderit me objekt "Ndërtim Ujësjetës në Fshatin Muriqan", rezultoi edhe në anulimin e tenderi me objekt "Mbikëqyrje e Punimeve për Ndërtim Ujësjetës në Fshatin Muriqan.


✓ **Progr-10460- Programi në fushën e Shërbimeve të Përkujdesjes në qarqe.**

Për vitin 2022, nga Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale është akorduar fondi në shumën 6,047 mijë lekë për vitin 2022, i cili është përdorë për shpenzime korrente, me destinacion për paga dhe sigurime shoqërore për 4 punonjës shtesë si dhe pagesat e orëve të natës dhe mbrëmjes, festa zyrtare, orë shtesë sipas nevojave të shtëpisë familje "Facibeni", ofruar nga Shoqata "Opera della Providenza Madonnina della Grappa".

Për këtë, në fillim të vitit 2022, është lidhur marrëveshja me Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Shoqata "Opera della Providenza Madonnina della Grappa" në zbatim të së cilës janë realizuar shpenzimet e planifikuara nga transferat e kushtëzuar nga MSHMS.

Ky program zë 4% të totalit të përgjithshëm të Buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2022.

Për periudhën 12/mujore shpenzimet janë realizuar në vlerë absolute në shumën 5,120 mijë lekë është realizuar në masën 85%.



Shoqata "Opera della Providenza Madonnina della Grappa", ushtron aktivitetin e saj prej 25 vitesh dhe strehon 18 persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç.

Misioni i kësaj shoqate është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e integritimit social të përfituesve ndërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për persona me aftësi të kufizuara.

Shërbimet që ofrohen në qender janë;

- ✚ Shërbimi rezidencial,
- ✚ Shërbimi mjekësor
- ✚ Shërbimi psiko-social,
- ✚ Aktivitete sociale ,kulturore,vizita
- ✚ Shërbimi sanitar.

3. Vetëvlerësimi financiar për periudhën Janar-Dhjetor 2022.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 26, datë 27.09.2019 “Proçedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, paragrafi 47, bashkangjitur ju dërgojmë Tabelën për **verifikimin e situates financiare** ne te cilen ndodhet Këshilli Qarkut Shkodër (**Aneksi 1**) dhe **Treguesit Fiskale te konsoliduar te NJVQV-ve** (**Aneksi 2**).

Siç shihet nga tabela sipas aneks 1”**verifikimin e situates financiare**” Totali I shpenzimeve të miratuara në buxhetin e vitit 2022, pa përfshite transfertat e kushtëzuara, është në shumën **127,045,835 lekë**. Këshilli Qarkut Shkodër nuk ka borxhe në formen e huave afatshkurtë apo afatgjatë si dhe detyrime ndaj të tretëve për shpenzime operative, korrente apo vendime gjyqësore. Theksojmë se KQShkodër, nuk ka detyrime me burim financimi nga pushteti qendror.

Në tabelën sipas aneksit 2, ‘**Treguesit Fiskale te konsoliduar te NJVQV-ve**’, paraqitet buxheti vjetor plan I ndare ne shpenzime per paga, sigurime shoqerore, shpenzime operative, të tjera korrente si dhe shpenzime kapitale.

Tek **Burimet e financimit**, tek te ardhurat e veta vendore jane perfshire plani I të ardhurave te vitit 2022 në shumën 2,090,000 dhe fondet e trashëguara nga viti 2021 në shumën 64,380,186 lekë.

Transferta e Pakushezuara e vitit 2022 ka qene 57, 734,434 leke.

Ne të ardhurat jashte limit jane shenuar fonde te mbetura ne Kap.6, të trashëguara nga vitet e mëparshme .

Tek financimi I huaj jane fonde ne shumen 2,231,164 lekë, të ardhura nga projekti.

Në faktin progresiv paraqitet realizimi I shpenzimeve për periudhën 12/mujore 2022 e cila është në vlerën 40,344,977 lekë e ndarë kjo sipas zerave të shpenzimeve korrente dhe kapitale.Tek burimet e financimit është shënuar fakti sipas shpenzimeve dhe përkatsisht nga të ardhurat e veta vendore në shumën 275,279 lekë dhe nga transferta e pakushtëzuar e vitit 2022 shuma prej 40,069,698 lekë.

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU

KRYETARI


Hilmi LAKTI

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"
KESHILLI QARKUT SHKODER

Viti 2022

ne 000/leke



Emri i Grupit		NJËSIE VETËQEVERISJES VENDORE		Kodi i Grupit		2033001		
Programet		Shpenzimet e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore						
Titulli	Emertimi	(1) Fakti i vitet paraardhes Viti 2021	(2) PBA Viti 2022	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	(5) Buxheti Vjetor Plani i Periudhes muajore 12/progresiv	(6) Fakti i Periudhes 12muajore/prog resiv	(7)=(6)-(5) Diferenca
0001	Programi 01110	23,163.7	39,740.0	40,265.0	40,265.0	40,265.0	24,960.0	-15,305.0
0002	Programi 01160	4,972.8	5,592.0	5,613.0	5,693.0	5,693.0	5,480.0	-213.0
0003	Programi 04520	3,568.0	18,721.0	23,362.0	23,362.0	23,362.0	15,110.0	-8,252.0
0004	Programi 04760	1,054.0	500.0	2,892.0	2,892.0	2,892.0	0.0	-2,892.0
0005	Programi 06370	200.0	11,242.0	60,526.0	60,526.0	60,526.0	275.0	-60,251.0
0006	Programi 10460	5,241.6	0.0	6,047.0	6,047.0	6,047.0	5,120.0	-927.0
.....							
Totali i Shpenzimeve të Njesisë		38,200.1	75,795.0	138,705.0	138,785.0	138,785.0	50,945.0	-87,840.0
Totali		38,200.1	75,795.0	138,705.0	138,785.0	138,785.0	50,945.0	-87,840.0

Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore	Emri	Hilmi LAKTI
	Firma	
	Data	24.02.2023

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER


ne 000/leke

QARKU	SHKODER														Kodi i Grupit / Njesisë Vendore
	Programi	01110													Kodi i Programit
Art.	Emertimi		-1	-2	-3	-4	-5						-6	2033001	
			Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	PBA Plan 2022	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Periudhës 12/Mujore/progressiv						Fakti i Periudhës 12 mujore/progressiv	(7)=(6)/(5) Diferenca	
600	Paga		13625.38	15000	15000	14880	14880	14880						13687	-1193
601	Sigurime Shoqërore		2240.95	2500	2500	2500	2500	2500						2289	-211
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		6048.45	10000	11400	11250	11250	11250						7452	-3798
609	fond rezerve		0	1500	1500	1500	1500	1500						0	-1500
604	Transferta Korente të Brendshme		700	800	1250	1400	1400	1400						850	-550
605	Transferta Korente të Huaja		317.93	400	352	352	352	352						305	-47
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		30	40	34	154	154	154						135	-19
Nen-Totali	Shpenzime Korrente		22962.71	30240	32036	32036	32036	32036						24718	-7318
230	Kapitale të Patrupëzuara														0
231	Kapitale të Trupëzuara		200.95	9500	7619	7619	7619	7619						242	-7377
232	Transferta Kapitale														0
Nen-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem		200.95	9500	7619	7619	7619	7619						242	-7377
230	Kapitale të Patrupëzuara		0	0	0	0	0	0						0	0
231	Kapitale të Trupëzuara		0	0	0	0	0	0						0	0
602	Financim I huaj Kap 6		0	0	610	610	610	610						0	610
Nen-Totali	Shpenzime me financim te huaj		0	0	610	610	610	610						0	-610
	Totali (korrente + kapitale)		23163.66	39740	40265	40265	40265	40265						24960	-15305
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyljana Miruku		Kryetari Njesisë Vetëqeverisjes Vendore												
Firma			Hilmi LAKTI												
Data	24.02.2023		Firma												
			Data												
			24.02.2023												
															

Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke


QARKU	SHKODER- DAMT												Kodi i Grupit / Njësishë Vendore	2033001	
Programi	01160												Kodi i Programit	91602AD	
Art.	Emertimi		-1	-2	-3	-4	-5						-6	(7)=(6)-(5)	
			Fakti i vitit paraardhës i vitit 2021	Plan 2022	Plan Fillestar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	Buxheti Vjetor Plan i Periudhes 12/Mujore/progressiv						Fakti i Periudhes 12 mujore/progressiv	Diferenca	
600	Paga		3967.48	4600	4600	4600	4600	4600						4431	-169
601	Sigurime Shoqërore		662.57	713	713	713	713	713						713	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		238.19	279	300	300	300	300						256	-44
603	Subvencione		0	0	0	0	80	80						80	0
604	Transferta Korente të Brendshme		0	0	0	0	0	0						0	0
605	Transferta Korente të Huaja		0	0	0	0	0	0						0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		104.6	0	0	0	0	0						0	0
Non-Totali	Shpenzime Korrente		4972.84	5592	5613	5693	5693	5693						5480	-213
230	Kapitale të Patrupëzuara														0
231	Kapitale të Trupëzuara														0
232	Transferta Kapitale														0
Non - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem		0	0	0	0	0	0						0	0
230	Kapitale të Patrupëzuara														0
231	Kapitale të Trupëzuara														0
232	Transferta Kapitale														0
Non - Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj		0	0	0	0	0	0						0	0
Totali	Shpenzime Kapitale		0	0	0	0	0	0						0	0
	Totali (korrente + kapitale)		4972.84	5592	5613	5693	5693	5693						5480	-213
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyljana Miruku		Kryetari Njësishë Vetëqeverisjes Vendore												
Firma															
Data	24.02.2023		Hilmi LAKTI												
			Firma												
			Data												



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke


QARKU	SHKODER								Kodi i Grupit / Njësish Vendore	2033001
Programi	04520								Kodi i Programit	9999999
Art.	Emertimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	-2 PBA Plan 2022	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	-5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhës 12/Mujore/progressiv			(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga	0		0	0	0	0	0	0	
601	Sigurime Shoqërore	0		0	0	0	0	0	0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0		0	0	0	0	0	0	
603	Subvencione	0		0	0	0	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	0		0	0	0	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja	0		0	0	0	0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0		0	0	0	0	0	0	
Non-Totali	Shpenzime Korrente	0	0	0	0	0	0	0	0	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0	0	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	3568	18721	23362	23362	23362	15110	-8252		
232	Transferta Kapitale	0					0	0		
Non-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	3568	18721	23362	23362	23362	15110	-8252		
230	Kapitale të Patrupëzuara							0		
231	Kapitale të Trupëzuara							0		
232	Transferta Kapitale							0		
Non-Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0		
Totali	Shpenzime Kapitale	3568	18721	23362	23362	23362	15110	-8252		
	Totali (korrente + kapitale)	3568	18721	23362	23362	23362	15110	-8252		
Drejtuësi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyljana Miruku	Kryetari Njësish Vetëqeveritjes Vendore								
Firma		Hilmi LAKTI								
Data	24.02.2023	Firma								
		Data								



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke


QARKU	SHKODER-	Kodi i Grupit / Njësisë Vendore	2033001					
Programi	04760	Kodi i Programit	9999999					
Art.	Emertimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	-2 PBA Plan 2022 Viti	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	-5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhës 12/Mujore/progressiv	-6 Fakti i Periudhës 12 mujore/progressiv	(7)=(-6)-(-5) Diferenca
600	Paga	0	0	0	0	0	0	0
601	Sigurime Shoqërore	0	0	0	0	0	0	0
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0	0	0	0	0	0	0
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	122	500	661	661	661	0	-661
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	0	0	0	0	0	0	0
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	122	500	661	661	661	0	-661
230	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0	0
230	Kapitale të Patrur./Projekti ADRIATICVES(Th+BND)	932	0	2231	2231	2231	0	-2231
231	Kapitale të Trupëzuara	0	0	0	0	0	0	0
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	0
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	932	0	2231	2231	2231	0	-2231
Totali	Shpenzime Kapitale	932	0	2231	2231	2231	0	-2231
	Totali (korrente + kapitale)	1054	500	2892	2892	2892	0	-2892
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyjana Miruku	Kryetari Njësisë Vetëqeveritjes Vendore		Hilmi LAKTI				
Firma		Firma						
Data	24.02.2023	Data						



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të programeve sipas artikujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke


QARKU	SHKODER									Kodi i Grupit / Njësish Vendore	2033001
Programi	06370									Kodi i Programit	9999999
Art.	Emertimi		-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	-2 PBA Plan 2022	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2022	-5 Buxheti Vjetor Plan i Periudhës 12 Mujore/progresiv	-6 Fakti i Periudhës 12 mujore/progresiv		(7)=(6)-(5) Diferenca	
600	Paga		0		0	0	0	0	0	0	
601	Sigurime Shoqërore		0		0	0	0	0	0	0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera		0		0	0	0	0	0	0	
603	Subvencione		0		0	0	0	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme		0		0	0	0	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja		0		0	0	0	0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ		0		0	0	0	0	0	0	
Nen-Totali	<i>Shpenzime Korrente</i>		0	0	0	0	0	0	0	0	
230	Kapitale të Patrupëzuara		0		0	75	75	75	75	0	
231	Kapitale të Trupëzuara		200	11242	60526	60451	60451	200	200	-60251	
232	Transferta Kapitale		0		0	0	0	0	0	0	
Nen -Totali	<i>Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm</i>		200	11242	60526	60526	60526	275	275	-60251	
230	Kapitale të Patrupëzuara									0	
231	Kapitale të Trupëzuara									0	
232	Transferta Kapitale									0	
Nen -Totali	<i>Shpenzime Kapitale me financim të huaj</i>		0	0	0	0	0	0	0	0	
Totali	<i>Shpenzime Kapitale</i>		200	11242	60526	60526	60526	275	275	-60251	
	<i>Totali (korrente + kapitale)</i>		200	11242	60526	60526	60526	275	275	-60251	
Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyljana Miruku		Kryetari Njësish Vetëqeverisjes Vendore			Hilmi LAKTI					
Firma			Firma		Firma						
Data	24.02.2023		Data		Data						



Aneksi 2. Raporti i Shpenzimeve të Programeve sipas artikulujve

KESHILLI QARKUT SHKODER

ne 000/leke

QARKU	SHKODER								Kodi i Grupit / Njesisë Vendore	2033001
Programi	10460								Kodi i Programit	91307AH
Art.	Emertimi	-1 Fakti i vitit paraardhës Viti 2021	-2 PBA Plan 2022 Viti	-3 Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2022	-4 Buxheti Vjetor Plan i Rishtikuar Viti 2022	-5 Buxheti Vjetor Plan i Periudhës 12/Mujore/progressiv	-6 Fakti i Periudhës 12 mujore/progressiv	(7)=(6)-(5) Diferenca		
600	Paga	0		0	0	0	0	0		
601	Sigurime Shoqërore	0		0	0	0	0	0		
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	0		0	0	0	0	0		
609	fond rezerve	0		0	0	0	0	0		
604	Transferta Korente të Brendshme	0		0	0	0	0	0		
605	Transferta Korente të Huaja	0		0	0	0	0	0		
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	5241.62		6047	6047	6047	5120	-927		
Non-Totali	Shpenzime Korrente	5241.62	0	6047	6047	6047	5120	-927		
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0	0	0	0		
231	Kapitale të Trupëzuara	0		0	0	0	0	0		
232	Transferta Kapitale	0		0	0	0	0	0		
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0	0		
230	Kapitale të Patrupëzuara	0		0	0	0	0	0		
231	Kapitale të Trupëzuara	0		0	0	0	0	0		
232	Transferta Kapitale	0		0	0	0	0	0		
Non -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0		
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0	0		
Totali	Totali (korrente + kapitale)	5241.62	0	6047	6047	6047	5120	-927		
Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Gjyjana Miruku	Kryetari Njesisë Vetëqeveritjes Vendore			Hilmi LAKTI					
Firma		Firma								
Data	24.02.2023	Data	24.02.2023							

Shenim; fonde te akorduara nga Ministria e Shendetise

ANEKSI nr.5 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"
KESHILLI QARKUT SHKODER

Projektet me financim te brendshem (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti 2022 Planifikuar	Plani i buxhetit viti 2022 12/m	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (12-mujore/vjetore e)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
0330056	Rrethimi e sistemimi I varrezave ne Puke	14,000	2022	2023	7,000	7,000	-	-	-	I perealizuar
0330061	Mbikq "Rreth e sist.I varrezave ne Puke	284	2022	2023	294	294	-	-	-	I perealizuar
0330062	Kolaud. "Rreth e sist.I varrezave ne Puke	25	2022	2023	25	25	-	-	-	I perealizuar
0330049	Ndertim ujesjellesi Muriqan	98,181	2022	2022	58,263	58,263	275	275	-	Proc. Tenderimi
0330053	Superviz. Ndertim ujesjellesi Muriqan	1,968	2022	2022	1,968	1,968	-	-	-	Proc. Tenderimi
0330054	Kolaudim Ndertim ujesjellesi Muriqan	295	2022	2022	295	295	-	-	-	Proc. Tenderimi
0330058	Sist.Asfaltim I rruge te Brend Nenshate	14,750	2022	2022	14,750	14,750	10,320	10,320	-	I realizuar
0330059	Sistem.Asfaltim rruga e varrez. Kalldrun	6,000	2022	2022	6,000	6,000	4,790	4,790	-	I realizuar
0330063	Mbikq. Inv Sistem.Asf. rruga Kalldrun	133	2022	2022	133	133	-	-	-	Kryer nga B.M.M.
0330064	kolaud. Inv Sistem.Asf. rruga Kalldrun	12	2022	2022	12	12	-	-	-	Kryer nga B.M.M.
0330035	Paisje kondicioneri		2022	2022	80	80	80	80	-	Realizuar
0330021	Orendi zyre		2022	2022	100	100	100	100	-	Realizuar
0330006	Te tjera Paisje zyre		2022	2022	120	100	62	62	-	Realizuar
	Totali 12/Mujor				89,040	89,040	15,627	15,627	-	

Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Grant/ Kredi	Vlera e plotë e projektit	Viti i fillimit të projektit	Viti i përfundimit të projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti	REALIZIMI për periudhën e raportimit (vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale
G033005	Projekti ADRIATICAVES	Grant/	6288	2018	2021	6288		0	0
									5230

Shenim; Projekti ka perfunduar me daten 31/3/2021.Vlera prej 2,231 mijë lekësh jane fonde të mbetura nga rimbursimet e shpenzimeve.
 Shih Aneksi 2 Progr.04760



Drejtesia e Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Emri	Kryetari i Njesisë së Vetëqeverisjes
	Firma	Firma	Vendore
	Data	Data	

KESHILLI QARKUT SHKODER

Treguesit financiare (sipas përcaktimeve të nenit 54, të ligjit 68/2018)

000/leke

Nr.	Treguesit kyçë financiarë	Fakt viti 2021	Fakti viti 2022	Plani viti 2023	Plani viti 2024	Plani viti 2025
1	Raporti I shpenzimeve të Përgjithshme ndaj te ardhurave te përgjithshme	33.06%	37.48%	100%	100%	100%
2	Raporti I të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave të përgjithshme	1.08%	1.49%	1.21%	2.82%	2.90%
3	Raporti I të ardhurave faktike nga taksat dhe tarifat vendore ndaj planit të tyre	38.03%	96.66%	100%	100%	100%
4	Raporti I shpenzimeve për investime kapitale ndaj shpenzimeve të përgjithshme	10.44%	11.50%	71.14%	55.80%	54.54%
5	Raporti I shpenzimeve për personelin ndaj shpenzimeve të përgjithshme	41.74%	11.76%	10.83%	25.33%	26.09%

**Nepunesi Zbatues
Gjyljana MIRUKU**



Nepunesi Autorizues

Hilmi LAKTI



Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare

Muaji Janar- Dhjetor 2022

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzi meve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a.1	Principali	0		
a.2	Interesi	0		
b	Hua afatshkurtër	0		
b.1	Hua	0		
b.2	Overdraft	0		
b.3	Kredi të furnitorëve	0		
II	Detyrime (a+b+c)	0		0.00%
a	Shpenzime korrente	0		
a.1	Mallra dhe shërbime	0		
a.2	Paga dhe sigurime	0		
a.3	Të tjera	0		
b	Shenzime kapitale	0		
b.1	Institucione buxhetore	0		
b.2	Subjekte private	0		
c	Vendime gjyqësore	0		
c.1	Marrëdhënie pune	0		
c.2	Mallra dhe shërbime	0		
c.3	Investime	0		
c.4	Të tjera	0		
III	Totali (I+II)	0	127,045,835	0.00%

Në lekë

Situata Normale e gjendjes financiare	Rasti i vështirësishë ku ndodhet njëra e vetëqeverisjes vendore			
	Probleme financiare Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15%	Vështirësi financiare Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25%	Vështirësi serioze financiare Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%	Paafësi paguese Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 130%
at Normale e gjendjes finan	0	0	0	0

Nëpunësi Zbatues

(Gjyljana MARIKU)

SHENIM

Stoku i detyrimit të mbetur duhet të rrikordoje me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit deri në periudhën për të cilën kryhet raportimi
 Në rast se bashkia rezultoi të ketë dhe detyrime me burim financimi nga pushteti qendror (ministri linje apo FSHZH), lutemi të percaktoni vlerat e tyre si me poshte:

Detyrime pushteti qendror	Logari a ekonomike	Vlera në lekë
Ministri linje xxx		0
FSHZH		0



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore

në lekë

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	2020200	2090000
1	Taksat e veta vendore	0	0
a.	Taksa mbi pasurinë		
b.	Biznesi i vogël		
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja		
d.	Taksa të tjera vendore		
2	Të ardhura jotatimore	2020200	2090000
a.	Tarifat e shërbimeve publike		
b.	Tarifa administrative		
c.	Të tjera jo tatimore	2020200	2090000
3	Taksa të ndara	0	0
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme		
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura		
c.	Renta minerare		
d.	Tatim mbi të ardhurat personale		
e.	Të tjera		
II	Shpenzime të Buxhetit Vendor	40344977	127045835
1	Shpenzime Korrente	24717888	33308060
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	13687068	14880000
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	2288734	2500000
d.	Shpenzime Operative	7452128	11250500
e.	Të tjera korrente	1289958	4677560
2	Shpenzime Kapitale	15627089	9373775
3	Burimet e Financimit	40344977	127045835
a.	Të ardhurat e veta vendore (te ardh te vitit + te trasheguara)	275279	66470186
b.	Transferta e pakushtezuar	40069698	57734434
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtezuar sektoriale		0
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit te trasheguara kap.6)		610051
f.	Financimi i huaj		2231164
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Nëpunësi Zbatues
(Gjylyana MIRUKU)

Nëpunësi Autorizues
(Hilmi LAKTI)

